
INTERDISCIPLINARITY, THE GREAT CHALLENGE OF TEACHING TODAY

Anastasi Prodani

Faculty of Foreign Languages, Tirana University, Albania, nastaproani@yahoo.com

Silvana Nini

IZHA (Institute of Education Development in Albania), silva_nini@yahoo.com

Abstract: Teaching nowadays is a challenge to ourselves, and we as teachers often have to deal with this fact. We need to be more and more focused on this global and extremely complex world, where phenomena, events and dates are intertwined, and consequently, their complexity need be explained. In this paper we will dwell on our experience in the auditorium with students of the Spanish Language Specialty, at the Spanish Language Department of the Faculty of Foreign Languages of the Public University of Tirana, where the cooperation between Art Teachers and History has woken interest in the subject. So our target group will be the Spanish Language students of the second year of Bachelor Studies, in the subject of Modern and Contemporary History of Spain (about 60 people) with B1 / 2 language level.

Preliminary data: Here we will dwell on the acquired knowledge of students in the pre-university system about the field in question. These data are taken from fieldwork by consulting 9- year and high school textbooks, as well as by group discussions, which we conduct at the beginning of each year, where students are invited to discuss or write “what you like and why and why not from the subject of history”. From this fieldwork it turned out that nearly all students hated history, as there were many dates, events and names and required reproduction. They pointed out that the use of films and documentaries, slides and other visual tools would make the teaching more attractive and more interactive.

Results and Conclusions: During the classes or as homework, in the form of assignments, documentary excerpts related to the subject calendar and the key moments of history are provided with the paintings of el Greco, Velasco, Murio, Goja and Picasso; also using during the teaching posters of the time, especially when talking about the period of the Civil War in Spain. By doing so we help their semantic memory with episodic fragments of an event ora moment or an era. But on the other hand, we educate them with taste for art, beauty, and also their expressive language, trying to get the learning process to a higher level. It is about promoting hidden creativity to students.

Through pictures and documentary, students get acquainted with the hypotheses about the key figures of the story in question; with opinions and thoughts expressed by historians themselves through documentaries, where students see that thoughts vary in function of the facts and documents available to one or another scholar. This is of paramount importance since in many magisterial lectures, knowledge is given as axioms and there is no room for interpretation, judgment and criticism. By providing students with history based on different schools of thought, we show them that there is absolutely no absolute and that things are moving. We also orient them towards safer, more reliable and up-to-date information. To increase the interest and the quality of teaching, we urgently need to introduce the IT tools that students have. This is a necessity of time and their use should be oriented to be in the function of learning and be used as an instrument.

Keywords: history, interdisciplinarity, visual arts, semantic memory

**NDËRDISIPLINARITETI, SFIDA E MADHE E MËSIMDHËNIES
NË DITËT TONA**

Anastasi Prodani

Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. nastaproani@yahoo.com

Silvana Nini

IZHA-s (Instituti I Zhvillimit Arsimor në Shqipëri). silva_nini@yahoo.com

Abstrakti: Mësimdhënie në ditët e sotme është një sfidë më vete dhe ne si mësimdhënës shpesh na duhet të përballemi me këtë fakt. Përherë e më shumë na duhet të orientohe mi në këtë botë globale dhe tepër komplekse, ku fenomene, ngjarje dhe data ndërthuren me njëra tjetrën dhe për pasojë dhe shjegimi i tyre do një përgatitje komplekse. Në këtë kumtesë do të ndalemi tek një eksperiencë jona në auditor me studentë të degës së gjuhës

spanjolle, të Departamentit të Spanjishtes, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit Publik të Tiranës, ku bashkëpunimi mes mësuese së Artit dhe të Historisë kanë zgjuar interesin ndaj lëndës. Pra si *target group* do të fokusohemi tek studentët e spanjishtes, viti i dytë i Studimeve Bachelor, në lëndën e Historisë Moderne dhe Bashkëkohore të Spanjës (rreth 60 vetë), me nivel gjuhe B1/2.

Të dhëna paraprake: Këtu do të ndalemi tek njohuritë e fituara të nxënësve në sistemin parauniversitar mbi fushën në fjalë. Këto të dhëna janë marrë nga puna në terren qoftë duke konsultuar librat e shkollave 9 vjeçare dhe të mesme, qoftë edhe nga diskutimet në grup, që ne zhvillojmë çdo fillim viti, ku studentët ftohen të diskutojnë apo të shkruajnë se çfarë ju pëlqen dhe pse po e pse jo nga lënda e historisë. Nga kjo punë në terren ka rezultuar se gati të gjithë studentët e urrenin historinë, pasi kishte shumë data, ngjarje dhe emra dhe kërkohej riprodhim i tyre. Atau shprehën që mësimi i historisë të bëhej më atraktiv, më interaktiv dhe të përdorëshin filma dhe dokumentarë, slide dhe mjete të tjera vizuale.

Rezultate dhe konkluzione: Gjatë orëve të historisë, qoftë në klasë apo në shtëpi, në formën e detyrave, paraqiten fragmente dokumentarësh që lidhen me kalendarin e lëndës dhe momentet kyçe të historisë jepen me pikturat e el Grekos, Velazquez, Murijo, Goya, Picasso. Duke vepruar kështu ne ndihmojmë memorien e tyre semantike me fragmente episodike të një ngjarje apo momenti, apo të një epoke. Por nga ana tjetër, u edukojmë atyre dhe shijen për artin, për të bukurën por gjithashtu edhe gjuhën e tij shprehëse duke u munduar që ta cojmë në një shkallë më të lartë procesin e të nxënësve. Bëhet fjalë për të nxitur kreativitetin e fshehur tek studentët.

Nëpërmjet pikturave, dokumentareve studentët njihen me hipotezat në lidhje me figurat kyçe të historisë në fjalë; me opinione dhe mendime të shprehura nga vetë historianët dhe kritikë arti, ku studentët shohin se mendimet variojnë në funksion të fakteve dhe dokumentave që disponon njëri apo tjetri studiues. Kjo ka një rëndësi të dorës së parë pasi në shumë leksione magjistrale, njohuritë jepen si aksioma dhe nuk lihet vend për interpretim, gjykim dhe kritikë. Ne duke ua ofruar studentëve historinë në bazë të shkollave të ndryshme të mendimit, u tregojmë atyre se nuk ka të vërtetë absolute dhe se gjërat janë në lëvizje. Gjithashtu i orientojmë ata drejt informacionit më të sigurt, më të besueshëm dhe të përditësuar.

Për të rritur interesin dhe cilësinë e mësimdhënies, urgjentisht duhet të fusim mjetet e IT që studentët disponojnë. Kjo është një domosdoshmëri e kohës dhe përdorimi i tyre duhet orientur që të jenë në funksion të mësimin, të përdoren si instrument.

Kjalët kyç: histori, interdisiplinariteti, artet pamore, memoria semantike

1. HYRJE

Mësimdhënia në ditët e sotme është një sfidë më vete dhe ne si mësimdhënës shpesh na duhet të përballemi me këtë fakt. Përherë e më shumë na duhet të orientojemi në këtë botë globale dhe tepër komplekse, ku fenomene, ngjarje dhe data ndërthuren me njëra tjetrën dhe për pasojë dhe shjegimi i tyre do një përgatitje komplekse. Në këtë kumtesë do të ndalemi tek një eksperiencë e jona në auditor me studentë të degës së gjuhës spanjolle, të Departamentit të Spanjishtes, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit Publik të Tiranës. Pra si *target group* do të fokusohemi tek studentët e spanjishtes, viti i dytë i Studimeve Bachelor, në lëndën e Historisë Moderne dhe Bashkëkohore të Spanjës (rreth 60 studentë). Lënda në fjalë është e një niveli gjuhe C1 sipas Kuadrit European të Gjuhëve dhe terminologjia gjegjëse e një niveli C1-C2. Harku kohor që përfshin lënda në fjalë kap një periudhë historike gati disashekullore: që nga zbulimi i Amerikës Latine, 1492, dhe deri në ditët tona (gati 5 shekulle). Ajo është e ndarë në dy pjesë: në Histori Moderne, ku ne do të ndalemi, dhe në Historinë Bashkëkohore deri në Historinë e së Tashmes. Në një hark kohor prej 15 javësh jepen konceptet kryesore mbi periudhën në fjalë dhe në dispozicion të saj janë vetëm 20 leksione dhe 20 seminare me secilin grup.

2. TË DHËNA PARAPRAKE

Këtu do të ndalemi tek njohuritë që studentët kanë fituar në sistemin parauniversitar mbi fushën në fjalë. Këto të dhëna janë marrë fillimisht nga diskutimet në grup me studentët e rinj, që ne zhvillojmë çdo fillim viti, ku ata ftohen të diskutojnë apo të shkruajnë se çfarë ju pëlqen, dhe pse po e pse jo nga lënda e historisë. Nga këto biseda dhe diskutime, rezultoi se gati të gjithë studentët e urrenin historinë, pasi kishte shumë data, ngjarje dhe emra dhe kërkohej riprodhimi i tyre. Ata u shprehën se mësimi i historisë duhet të bëhet më tërheqës, më interaktiv dhe të përdoren filma dhe dokumentarë, slide dhe mjete të tjera vizuale të aksesueshme nga ata me mjetet teknologjike që disponojnë. Madje gjatë diskutimeve me ta arritëm deri aty sa në mes nesh nuk e quajtëm më lëndën me emërtimin e kurrikulës, por e quajtëm Qytetërim, gjë që solli një ndjesi çlirimi dhe përkushtimi të ri. Duke u përpjekur për të gjetur shkaqet e një fenomeni të tillë refuzues ndaj historisë, si dhe në përpjekje për të përmirësuar procesin e të

nxënit, u realizua një kërkim në terren, si nëpërmjet takimeve me mësuesit/et e historisë ashtu edhe duke shfletuar librat shkollorë të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm. Nga vëzhgimi i situatës në terren u arrit në konkluzionin se niveli i dobët i njohurive të tyre në këtë fushë ishte sepse tekstet shkollore qenë përgatitur në shumicën e rasteve nga pedagogë të universitetit dhe terminologjia e përdorur e kalonte cakun e njohurive të tyre. Së dyti, gjatë shfletimit të totalit të librave, vumë re se historia e Spanjës zinte një hapësirë shumë të vogël, për të mos thënë të pakonsiderueshme në librat e historisë botërore. Së treti, në bisedat me studentët ata shprehen se mësuesit përipiqen të ngarkojnë memorien e nxënësve me ngjarje, data, emra dhe vende, duke humbur kështu vizionin global dhe misionin e studimit të lëndës së historisë, e cilësdo periudhë historike qoftë, që në pak fjalë përmbledhet në atë që: të mësosh histori do të thotë të hulumtosh të shkuarën për të ditur përsetë e të tashmes në mënyrë që të dimë të ndërtojmë të ardhmen.

Me marrjen e një feedback-u të tillë, nuk mbeti gjë tjetër veçse të hidheshim në një ndërmarrje të re. Dispencat e historisë u zhvendosën në plan të dytë dhe në bashkëpunim me mësimdhënësin e didaktikës së arteve pamore, u rishikua metodologjia e mësimdhënies në lëndën e historisë duke i dhënë një rol më të madh manifestimit pamor. Në power point, përveç çështjeve për diskutim dhe pikave kryesore të informacionit, bashkangjitem harta të kohës, veprat përfaqësuese të artistëve më në zë të kohës, grafika dhe imazhe të periudhës së historisë moderne. Gjithashtu përzgjedhëm nga interneti fragmente filmash dokumentarë (video/audio) dhe jo vetëm. Menjëherë u vu re një rritje e interesit të studentëve në klasë, u rrit pjesëmarrja e tyre në orët e seminareve dhe angazhimi i tyre në orët e studimit në shtëpi.

Duke u bazuar tek udhëzuesi mësimor i lëndës së Historisë Moderne të Spanjës, ne e kemi të qartë, që në fillim të kursit akademik, se kjo është një lëndë hyrëse dhe e përgjithshme që zë fill nga fundi i mesjetës dhe deri te lufta për pavarësi e popullit spanjoll dhe te procesi i formimit të kombit. Një informacion i tillë u përcillet dhe studentëve që në orët e para, duke i vënë në dijeni mbi numrin e orëve të leksioneve, seminareve dhe tutorive. Ata gjithashtu njihen me kompetencat e përgjithshme që synon kjo lëndë të mbrujë tek ta të tilla si: *Kompetenca për jetën dhe sipërmarjen*¹¹⁹ në të cilën përfshihet aftësia për të zhvilluar shprehitë e arsytimit, argumentimit dhe menaxhimit të njohurive, si përmes përzgjedhjes së materialeve, ashtu edhe përmes diskutimit dhe prezantimit të rezultateve; *Kompetenca e të menduarit* ku përfshihet aftësia për të nxitur mendimin analitik, kritik, logjik dhe krijues, sidomos për këtë të fundit duhet punuar më shumë, fillimisht me nxitjen e interesit dhe pastaj me njohjen e shenjave, karakteristikave dhe detajeve që përdoren në funksion të realizimit të idesë; *Kompetenca personale* ku përfshihet besimi te vetja në pëmbushjen e detyrave dhe pjesëmarrja aktive si në procesin mësimor ashtu edhe në komunitetin studentor e më gjerë.

Gjithashtu duke u ndalur në kompetencat specifike të lëndës, gjithmonë sipas Kuadrit Europian përparësi dhe vëmendje të veçantë duhet tu jepet edhe kompetencave të tjera, që ndërthuren me kompetencat e lëndës të tilla si: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit* gjatë mësimimit të historisë përfshin kapacitetin për komunikim adekuat me gojë dhe me shkrim dhe njohuri për terminologjinë kyçe. Ndërthurja e njohurive në fushën e historisë me artin vizual (përfshijmë këtu edhe dokumentarë mbi historinë e artit apo dokumentarë historikë), sidomos për studentët që mësojnë një gjuhë të huaj siç është rasti në fjalë, ka një rëndësi parësore pasi studenti kombinon shprehitë artistike me ato historike si p.sh: komunikon drejtë mesazhin e veprave të artit brenda kontekstit historik dhe anasjelltas. Gjithashtu jo vetëm përthithin njohuri mbi periudhën historike dhe artin si një pasqyrim të saj, por edhe formojnë dhe mprehin aftësitë e tyre në gjuhën spanjolle. Në këtë kuadër, duke imituar provimet DELE, vëmë në klasë pjesë nga dokumentarë të ndryshëm për 10/15 min dhe pasi e dëgjojnë dhe/ose e shohin dy herë, u kërkohet po brenda orës së seminarit një detyrë me shkrim me një numër të caktuar fjalësh sipas standarteve të Kuadrit Europian të Gjuhëve (250-300 fjalë në varësi të kohës në dispozicion). Këtu përmendim edhe *kompetencat digjitale* që duhet të zotërojnë studentët, ose më mirë të themi përdorimin e këtyre kompetencave në kërkimin dhe menaxhimin e informacionit në internet. Kështu për të rritur interesin dhe cilësinë e mësimdhënies/mësimnxënies, mjaft mirë mund të vemë në përdorim mjetet e teknologjisë, që secili student i ka dhe i përdor si: celularët, tabletat, kompjuterat, dhe praninë e internetit (wi-fi) në auditorët e universitetit. Në këtë mënyrë, këto mjete teknologjike të përdorura shpesh herë jashtë kontekstit mësimor (për probleme personale) nga studentët, nëpërmjet një orientimi të duhur mund t'i shndërrojmë në instrumenta të vlefshëm didaktikë brenda procesit mësimor. Nëpërmjet punës në grup dhe rritjes së ndjeshmërisë ndaj çështjeve sociale promovojmë dhe realizojmë *kompetencat qytetare* që janë të një përparësie themelore në angazhim ndaj etikës dhe përgjegjësisë si qytetarë dhe si profesionistë në komunitetin përkatës. Pjesë e rëndësishme e kompetencave qytetare është edhe vlerësimi dhe bashkëpunimi ndërkulturor: njohja

¹¹⁹ Sipas “Guías docentes del Departamento de Español”, FGJH, UT.

e proceseve historike të multikulturalizmit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit kulturor qoftë në rajonin medhetar, meqë Spanja dhe Shqipëria janë në Marenostrom, por qoftë dhe në planin global. Një gjë e tillë arrihet nëpërmjet referencave për Shqipërinë ndërkohë që studiojmë fenomenet, ngjarjet, proceset në Las Espanas. Është detyrë e mësimit që të qasë studentët me këto fenomene të Shqipërisë aktuale, me anë të referencave historike në tema të tilla si krijimi i burokracisë në Spanjë (dhe krahasimi me Shqipërinë); krijimi i aparatit shtetëror, regjistrimi i parë i popullsisë, regjistrimi dhe deklarimi i të ardhurave, urbanizimi dhe rregullimi i territorit, normat në veshje dhe sjellje, procesi i shtetformimit dhe kombit, ndarjen e pushteteve, luftë çlirimtare dhe për pavarësi si dhe çështje të tjera, të cilat gjithnjë sillen në planin krahasues. Së fundmi, por për nga renditja, dhe jo nga rëndësia është edhe *kompetenca e të mësuarit për të nxënë* ku përfshihen: përdorimi i njohurive ndërdisiplinore në përcaktimin e temave kërkimore që mund të kontribuojnë në njohuritë dhe debatin historik dhe puna e pavarur në përzgjedhjen e burimit të informacionit me kapacitetin dhe iniciativën e vetë studentëve. Parë në këtë këndvështrim, pra se çfarë aftësish duhet të skalisin studentët tanë, historia ka nevojë për ndërveprim me fushat e tjera të dijesh universale.

3. STUDIMI I RASTIT

Lënda e Historisë Moderne të Spanjës zë gati gjysmën e leksioneve dhe periudha që po trajtojmë shtrihet në tre leksione. Kjo është një ndër periudhat ku hegjemonia spanjolle mbërrin kulmin e vet dhe që në Historiografi njihet me shumë emërtime, të tilla si: *Perandoria katolike, Perandoria e Habsburgëve, Perandoria e Oborreve mbretërore*. Pra bëhet fjalë për shekullin e gjashtëmbëdhjetë që përkon me kohën e sundimit të perandorit Karlosit I të Spanjës apo V i Gjermanisë si dhe të pasardhësit të tij Filipit II¹²⁰. Ndërthurja me fushën e artit pamor, ku pasqyrimi i momenteve kyçe të historisë përbën një sfidë në auditor pas mësimit që duhet të njohë edhe gjuhën artistike, elementët shprehës të autorit dhe kuptimin e simbolikës së tij. Paraqitja e pikturave të mjeshtrave spanjollë, flamandë dhe italianë, i jep një frymëmarrje tjetër auditorit. Kjo metodë, e përdorimit të fragmenteve episodike të ngjarjeve, momenteve historike apo jetësore të një epoke, ndihmon memorien semantike. Por nga ana tjetër, u edukon studentëve edhe shijen për të bukurën, për artin dhe gjuhën e tij shprehëse, duke mundësuar kështu ngritjen në një shkallë më të lartë të procesit të të nxënës. Bëhet fjalë për nxitjen e kreativitetit tek studentët. Kjo nuk do të thotë që ta shohim artin si objekt studimi më vete, por duke parë kontekstin historik në veprat e artit. Pra atë që po paraqesim në vijim është se nëpërmjet interpretimit dhe vlerësimit të një veprë arti, mprehen shprehjet e studentëve për të dalluar ata elementë, tipare dhe detaje që ndihmojnë në kuptimin e vetë kontekstit historik, pra të periudhës kur është prodhuar. Nuk mund të kuptojmë artin e të kaluarës (te popujt parahistorikë dhe primitivë) pa ditur qëllimet në shërbim të të cilëve ishte vënë arti.¹²¹ Krijimet që ne i quajmë artistike sot ishin në fakt punime ose objekte që si pikësnyim parësor nuk pretendonin të ishin të “bukura”, por së pari të pëmbushnin kriteret utilitare. Në qytetërimet antike dhe në mesjetë “Artistët” u përmbaheshin normave ose konvencioneve të lidhura ngushtë me vlerat dhe mënyrën e jetesës të periudhës që ata jetuan.

Me epokën e Rilindjes artistët fituan pak nga pak individualitet dhe bashkë me të prestigjin që u takonte, por megjithatë ata vazhdonin të punonin nën hyqmin e *mecenas*, njerëz të pasur të aftë për të vlerësuar talentin e tyre unik, që i mbështesnin artistët në mënyrë që ata të mund të zhvillonin artin e tyre duke influencuar në zgjedhjet e tematikat e tyre. Në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë fokusi kulturor dhe artistik që në Romë, ku papët u bënë patronët e vërtetë dhe, qenë artistët e mëdhenj si Raphael ose Bramante, ata që kompozuan vepra artistike që imitonin fuqinë e tyre si në kohën e perandorëve të Romës antike. Rilindja Italiane u zhvillua gjatë *Quattrocento-s* dhe *Cinquecento-s* në një mënyrë unikale pasi në këtë periudhë ka pasur rrethana unike, të cilat kontribuan në një shkëlqim mahnitës kulturor dhe artistik. Këto rrethana ndodhën vetëm në Itali. Në pjesën tjetër të Evropës Perëndimore arti ishte ende i lidhur me një traditë fetare shumë tradicionale, e cila vazhonte të ishte besnike ndaj artit gotik. Klima optimiste dhe e hapur në qytetet italiane kaloi në krizë dhe në vitin 1495. Një revoltë fetare shpërtheu në Firence, e drejtuar nga një prift dominikan, Savonarola, i cili dëboi Medici-ët dhe përdoqi të gjitha format e artit. Më vonë do jetë Martin Luteri, në Gjermani, që botoi 95 tezatat në vitin 1517, duke vënë në dyshim autoritetin e Papës. Në Perandorinë e Habsburgëve fisnikët dhe mbretërit kërkonin vepra arti për të treguar prestigjin dhe fuqinë e tyre. Nga fundi i shekullit të XV, këta zotërinj të mëdhenj, *los mecenas*, filluan të interesoheshin për

¹²⁰ Prodani, Anastasi, *Manual de Historia Moderna y Contemporanea*, Departamentit i Spanjishtes, FGJH, UT, kapitulli: “La nueva monarquía de los Habsburgo. Carlos I (1516-1556) y La monarquía hispánica de Felipe II (1556-1598)”, f.19- 42.

¹²¹ Gombrich, E. H., *Historia e Artit*, Fondacioni Soros, Botimi i 16-të, f. 39, 1996.

artet italiane. Artistët europianë gjithashtu bënë udhëtimet e para në Itali, veçanërisht në Venecia dhe Romë, për të njohur veprat e mjeshtrave të mëdhenj të dy shkollave të mëdha.

Në kritikën e tij ndaj Kishës zyrtare, Luteri sulmoi kultin e shenjtoreve dhe vuri në pikëpyetje praninë e imazheve në kisha. Në reagim, Kisha Katolike mblodhi Këshillin e Trentos (1545-1563), ku mbrojtë imazhet fetare, duke deklaruar se, tash e tutje, ato duhet të realizohen për të prekur dhe për të zgjuar përkushtimin e besimtarëve ndaj besimit katolik. Në këtë mënyrë, tendenca anti-klasike në artin fetar u theksua edhe më shumë. Në territoret e Habsburgëve, që përfshinin Spanjën, Gjermaninë dhe Vendet e Ulëta, kultura u dominua nga një kulturë fetare e ekzaltuar, për pasqyrimin e së cilës, klasicizmi italian nuk ishte i përshtatshëm. Ajo mori formë, tipare dhe maniera të tjera duke u mbështetur kryesisht tek gjuha gotike dhe manierizmi, të cilat thyen normat klasike për të pasqyruar frymën transcendentale dhe mbinatyrore në tablotë e tyre me temë fetare, ku synimi kryesor ishte indoktrinimi i besimtarëve katolikë për të arritur në një devotshmëri katolike të pakontestueshme. Në veprat e asaj kohe dallohet se si territoret nën Perandorinë Katolike, hispanike katolike dhe të Mbretërisë së Madhe Romane kanë marrë një tendencë tjetër të zhvillimit të artit pamor nga Gadishulli Apenin pasi dhe konteksti historik ishte shumë i ndryshëm. Megjithatë, stili klasik gjithashtu kishte vendin e vet. Duke qenë se kishte referenca kulturore të botës së lashtë, monarkët Habsburgë, princat e tjerë europianë dhe fisnikëria në përgjithësi e konsideruan atë si më të përshtatshëm për të përfaqësuar dinjitetin dhe fuqinë mbretërore. Kështu u zhvillua dhe kjo formë e artit zyrtar nën perandorin e Karlosit I të Spanjës dhe të V të Gjermanisë, në të gjitha territoret e perandorisë, si dhe të djalit të tij Filipi II. Është koha kur Perandoria hispanike ishte një perandori ku dielli nuk perëndonte kurrë dhe gjithë kjo periudhë lulëzimi dhe pushteti reflektohet edhe në artin e kohës, në cilësinë dhe madhësinë e veprave të artit që zbkuronin kishat dhe ndërtesat e oborreve mbretërore.

Këto tema ndjekin ikonografinë tradicionale të Mesjetës, dhe kanë tendencën të përsërisin veten, sidomos tema të tilla si Pasionin e Krishtit, duke ndjekur gjithmonë të njëjtat skema. Gjithashtu u shfaqën edhe disa lloje imazhesh që gjetën përhapje të madhe me kalimin e kohës, të tilla si gjysmë-trupa të shenjtoreve, ose të Krishtit apo Virgjëreshës Mari gjatë Pasionit, ku ata pasqyroheshin në një mënyrë mallëngjyese për të shtyrë besimtarët në reflektim, lutje dhe devotshmëri. Në funksion të shpjegimit sa më të qartë të situatës dhe frymës së shekullit në fjalë na vjen dhe vepra e El Greco-s, piktori nga ishulli i Kretës, Domenico Theotocopulos (1541-1614), i cili i magjepsur nga arti i Tintoretto-s, i paraqiti legjendat e shenjta në një mënyrë të re e emocionuese¹²². Ato patën një jehonë në vazhdim në mbrojtje të ortodoksisë katolike pasi ai kishte bërë të vetën manierizmin e figurave gjatoshë në kompozimet e tij, duke zgjedhur këtë mënyrë artistike të të shprehurit në art. Pikërisht kompozimet e pjerrëta dhe figurat e zgjatura i shërbenin mjaft mirë frymës mistike në tablotë e El Grecos. Përmendim këtu një nga pikturat e tij më tronditëse dhe emocionuese "Hapja e Qiellit të Pestë të Apokalipsit" rreth vitit 1608-14. El Greco ishte një figurë e rëndësishme e pikturës spanjolle, dhe një kontribues i rëndësishëm në artin e kundër-reformës katolike. Ai u bë i njohur për pikturat e tij fetare, të cilat në njëfarë mënyre arritën të kombinonin traditat bizantine me artin akademik perëndimor. Vepra e tij shkon drejt manierizmit¹²³, që është tranzicioni mes Rilindjes dhe Barokut. Kështu në pikturë bashkë-kohësonin stile të ndryshme, ku secili stil kishte simbolet dhe domethënien e vetë që lidhej me audiencën të ndryshme. Përkundër ashpërsisë që u imponohej çështjeve fetare, fisnikët dhe mbretërit, nga ana tjetër, urdhëruan për koleksionet e tyre private shumë piktura profane dhe mitologjike, sidomos të Tizianit, i cili ishte piktori i preferuar i Karlosit V dhe i Filipit II, veprat e të cilit i gjejmë në El Escorial. Në këtë mënyrë, u ruajt një traditë e cila do të jetë shumë e rëndësishme në artin pasues, në atë të pikturës barroke. Në paraqitjet piktorike të Karlosit V jepet pompoziteti i pikturave mbretërore ku thënia "PLVS VLTRA" ka një vlerë të dyfishtë, pasi nuk aludon vetëm «të kalojë materialisht Më Përtej territoreve të pushtuara se kufijtë e caktuar nga Herkuli», por kryesisht ka kuptimin «të kalojë Më Përtej tij në virtyte, vlera, famë dhe lavdi»¹²⁴. Një vepër tjetër e Ticianit është ajo e Karlosit V në betejën e Mühlberg. Nëpërmjet këtyre dy pikturave përmbledhet esenca e kohës, referencat artistike, fetare dhe mitologjike, kur autorët me penelatat e tyre polikromatike lartësojnë portetin regio të Karlosit V.

¹²² Gombrich, E. H., *Historia e Artit*, Fondacioni Soros, Botimi i 16-të, 1996, f. 371-372

¹²³ *Entierro del señor de Orgaz, el Expolio, el Caballero de la mano en el pecho, la Vista de Toledo, el Martirio de San Mauricio.*

¹²⁴ Arroyo Esteban, Santiago y Vázquez Dueñas, Elena, *Imagen de regia majestad: Carlos V y Felipe II en las Fuentes impresas de la Biblioteca Histórica "Marqués de Valdecilla"*, f. 31, në <http://biblioteca.ucm.es/pecia/doc17648.pdf>, [konsultuar më 20 prill 2018]

Si konkluzion mund të themi se piktura fetare ishte ajo që mbizotëronte kohën me tema thuajse absolutisht fetare, me tone përtej-tokësore, mbinatyrore, pa elementë dhe mënyra profane apo mitike, në kontrast të madh me artin në Itali. Në territoret ku shtrihej Perandoria hispanike ajo ishte e orientuar drejt përkushtimit ndaj zotit, veçanërisht pas krizës fetare të provokuar nga Reformimi protestant dhe pas rrezikut që i kanosej Europës së krishterë nga invazioni otoman¹²⁵.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Alfredo Floristan, (coord.), *Historia de España en la Edad Moderna*, Barcelona, Ariel, 2009.
- [2] J. Prats, J. E. Castello et al. *Geografía e Historia de España*, Ediciones ANAYA, 1987.
- [3] Anastasi Prodani, *Manual de Historia Moderna y Contemporanea*, depozituar pranë Departamentit të Spanjishtes, FGJH, UT.
- [4] Santiago Arroyo Esteban, Elena Vázquez Dueñas, *Imagen de regia majestad: Carlos V y Felipe II en las Fuentes impresas de la Biblioteca Histórica "Marqués de Valdecilla"* në <http://biblioteca.ucm.es/pecia/doc17648.pdf>, [konsultuar më 20 prill 2018]
- [5] E. H. Gombrich, *Historia e Artit*, Fondacioni Soros, Botimi i 16-të, 1996.
- [6] Belén. P. Trigueros (coord.), *Historia del Arte. Humanidades y Ciencias Sociales, Artes*, EDELVIVES, 2009.
- [7] Guías docentes del Departamento de Español, FGJH, UT.

PIKTURAT

- [8] <https://www.museodelprado.es/en/whats-on/exhibition/the-art-of-power-the-royal-armoury-and-court/41c17072-f29b-41b5-b0a1-2a7d45d4f8e4>. [konsultuar më 20 prill 2018]
- [9] Francesco Parmigianino, Portret i Karlosit I ose V. 1530. https://www.google.al/search?q=Francesco+Parmigianino++Retrato+de+Carlos+V.+1530.&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjfxrqktN3aAhXCyaYKHQX0ATUQ_AUICigB&biw=1517&bih=735#imgrc=6SuSWUr92QLpjM: . [konsultuar më 20 prill 2018]
- [10] Tiziano, Karlos V në Betejën e Mühlberg-ut, https://www.google.al/search?q=comentario+carlos+v+de+tiziano&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwjGsYCd93aAhWBFCwKHcnyCqwQ_AUICigB&biw=1517&bih=735#imgrc=sW528_5K2wvj3M: . [konsultuar më 19 prill 2018]
- [11] FilipiII, https://www.google.al/search?q=Tiziano+Vecellio+Felipe+de+Augsburgo+en+armadura.+1551+Madrid,+Museo+Nacional+del+Prado&source=lnms&tbn=isch&sa=X&ved=0ahUKEwj7xKWzut3aAhVCLZoKH_eMZBBMQ_AUICigB&biw=1517&bih=735#imgrc=MC4PNHp5VcQRpM: . [konsultuar më 22 prill 2018]
- [12] <http://www.visual-arts-cork.com/history-of-art/spanish-baroque-artists.htm> [konsultuar më 20 prill 2018]
- [13] https://en.wikipedia.org/wiki/Opening_of_the_Fifth_Seal#/media/File:The_Vision_of_Saint_John_MET_D_T1052.jpg

¹²⁵ Floristan, Alfredo (coord.), *Historia de España en la Edad Moderna*, Barcelona, Ariel, 2009, f. 175- 187.